



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 02, datë 27.02.2019

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“APLIKIMI I TEKNIKËS MË TË FUNDIT TË EFICENCËS NË GODINËN E MIE (ISH-
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS), BASHKIA TIRANË”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:



1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Aplikimi i teknikës më të fundit të efijencës në godinën e MIE (ish-Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës), Bashkia Tiranë”, me subjekt zhvillues Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

